

VENDIM
Nr.445, datë 13.7.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.785, DATË 22.11.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË
STRUKTURËS E TË NIVELIT TË PAGAVE, TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE TË
KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.785, datë 22.11.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.3, e përmendur në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 8, “vlera 31 764” zëvendësohet “me vlerën 35 900”.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, , të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR. 3

Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve të administratës së Këshillit
Kombëtar të Kontabilitetit

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Drejtor ekzekutiv.	II-b	10.050	2%	0	84.000
Inspektor	III-a	10.050	2%	0	65.000
Specialist.	IV-b	10.050	2%	0	25.850